

BARKODI



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
 MINISTRIA E ARSIMIT  
 DHE SPORTIT  
 QENDRA E SHËRBIMEVE ARSIMORE

## MODEL TESTI I MATURËS SHTETËRORE PROFESIONALE 2025

### KUALIFIKIMI PROFESIONAL "SHËRBIME TË UDHËTIMIT DHE TURIZMIT"

#### Udhëzime për maturantin/kandidatin

Testi përmban gjithsej **60 pikë**.

Koha për zhvillimin e pyetjeve të testit është **2 orë e 30 minuta**.

Testi ka **20 pyetje me zgjedhje (alternativa)** dhe pyetjet e tjera janë me zhvillim.

Pikët për secilën pyetje janë dhënë përbri saj.

#### Për përdorim nga komisioni i vlerësimit

Kërkesa	1	2	3	4	5	6	7	8
Pikët								
Kërkesa	9	10	11	12	13	14	15	16
Pikët								
Kërkesa	17	18	19	20	21	22	23	24
Pikët								
Kërkesa	25	26	27	28	29	30		
Pikët								

Totali i pikëve

KOMISIONI I VLERËSIMIT

1.....Anëtar

2.....Anëtar

1. Një biznes hotelier/gastronomik që zhvillon aktivitetin në një zonë të caktuar, ka si destinacion jo vetëm ofrimin e shërbimeve për klientët potencialë, por i shërben edhe komunitetit të zonës, në forma të ndryshme. Ndërmarrja bëhet mik i komunitetit kur: **1 pikë**

- A) Nuk punëson banorë të zonës
- B) Pakëson hapësirat e gjelbra
- C) Investon në infrastrukturë
- D) Prish qetësinë publike

2. Një ndër detyrat e personelit të shërbimit në hotel, është garantimi i sigurisë së klientëve gjatë qëndrimit në hotel. Portieri i natës ka për detyrë: **1 pikë**

- A) Të pastrojë dhomat e klientit
- B) Të ndihmojë në kuzhinë
- C) Të ndihmojë në lavanteri
- D) Të sigurojë qetësinë në hotel

3. Dhoma e ngrënies në një hotel të standardizuar shërben si mjedis ngrënie për: **1 pikë**

- A) Klientët e akomoduar në hotel
- B) Personelin
- C) Klientët e jashtëm
- D) Asnjëra më lart

4. Në disa raste, pronarët e objekteve nuk e menaxhojnë vetë objektin e tyre, për arsye të ndryshme, por e transferojnë përdorimin e tyre tek njerëz të tjerë. Qiramarrja e një objekti është: **1 pikë**

- A) Blerja e objektit
- B) Shitja e objektit
- C) Marrja në pronësi e objektit
- D) Marrja në përdorim e objektit

5. Në një strukturë hoteliere, restoranti dhe kuzhina lidhen mes tyre nëpërmjet ambienteve ndërmjetëse. Cili prej mjediseve mundëson lidhjen e restorantit me kuzhinën në hotel: **1 pikë**

- A) Holli i hotelit
- B) Receptioni
- C) Lavanteria
- D) Korridori i kamerierëve

6. Mbrojtja e vlerave të njerit prej lumenjve në Shqipëri ka tërhequr vëmendjen e opinionit ndërkombëtar. Për cilin prej lumenjve bëhet fjalë: **1 pikë**

- A) Lumin Osum
- B) Lumin Vjosë
- C) Lumin Shkumbin
- D) Lumin Bunë

7. Qytetet shqiptare tërheqin turistë vendas dhe të huaj. Një prej tyre është Antigonea e cila frekuentohet për vlerat e larta: **1 pikë**
- A) Sportive
  - B) Kulturore
  - C) Kurative
  - D) Natyrore
8. Faktorët që ndikojnë në sjelljen e turistëve ndahen në faktorë të brendshëm dhe të jashtëm. Cili prej faktorëve të mëposhtëm është faktor i motivimit të brendshëm: **1 pikë**
- A) Ndryshimet e tregut
  - B) Kultura dhe klasa sociale
  - C) Familja dhe moshë
  - D) Perceptimi i turistit
9. Një nga llojet më të rëndësishme të turizmit në Shqipëri është edhe turizmi kulinar, për shkak të ofertës gastronomike që ofron. Fokusi i turizmit kulinar **NUK** përfshin: **1 pikë**
- A) Përjetimin e eksperiencave të një sistemi ushqimor
  - B) Zvogëlimin e pjesëmarrjes në këtë segment tregu
  - C) Lidhjen ndërmjet destinacionit dhe kulturës
  - D) Ri zbulim të ritualeve të lidhura me ushqimin
10. Shqipëria ofron destinacione turistike me një pamje magjepsëse duke rritur kështu imazhin e turizmit sidomos tek turistët e huaj. Faktori më i rëndësishëm pozitiv në turizmin shqiptar është: **1 pikë**
- A) Niveli i infrastrukturës
  - B) Niveli ekonomik
  - C) Eksperiencat turistike
  - D) Pozita gjeografike
11. Ministria e turizmit dhe e mjedisit, vitet e fundit po harton politika për një zhvillim të qëndrueshëm të turizmit në Shqipëri. Cili është qëllimi kryesor i turizmit të qëndrueshëm; **1 pikë**
- A) Mbështetja e zhvillimit të turizmit
  - B) Sigurimi i vazhdimësisë
  - C) Ruajtja e kulturave lokale të një vendi
  - D) Mbështetja e ekonomive lokale
12. Në strukturën e ndërmarrjeve të udhëtimit, ka punonjës të dedikuar si agjentë turistikë. Cili është roli i agjentit turistik; **1 pikë**
- A) Të shoqërojë personalisht turistët gjatë tour-it
  - B) Të krahasojë çmimin e paketave të tour-operatorit
  - C) Të shesë paketat e tour-operatorit
  - D) Të bashkojë paketat turistike

13. Në përcaktimin e numrit të personelit të shërbimit, në sektorë të ndryshëm të industrisë së mikpritjes, ndikojnë disa faktorë të rëndësishëm. Cili nga faktorët NUK ndikon në përcaktimin e numrit të personelit në restorant: **1 pikë**

- A) Kapaciteti pritës i sallës
- B) Mënyra e pagesës nga klientët
- C) Kategoria dhe cilësia e restorantit
- D) Numri i klientëve që frekuentojnë restorantin

14. Drejtimi i ndërmarrjes nga një pronar ka disa avantazhe. Rrethoni më poshtë cila prej alternativave NUK bën pjesë në anët pozitive të kësaj forme drejtimi: **1 pikë**

- A) Vendos vetë për çdo problem
- B) Fitimi është vetëm i pronarit
- C) Mundësia e falimentimit është më e madhe
- D) Është më pak e besueshme nga bankat

15. Sipërmarrësit e suksesshëm kanë disa tipare të përbashkëta. Cila nga alternativat më poshtë, është pjesë e aftësive ndërpersonale, si një nga tiparet e sipërmarrësit: **1 pikë**

- A) Mendimi krijues
- B) Përcaktimi i qëllimit
- C) Toleranca ndaj rrezikut
- D) Udhëheqësia dhe motivimi

16. Komunikimi që realizohet përmes letrave, postës elektronike, mediave sociale, librave, revistave, internetit dhe mediave të tjera quhet: **1 pikë**

- A) Komunikim jo verbal
- B) Komunikim me shkrim
- C) Komunikim i folur ose verbal
- D) Komunikimi përmes vizualizimeve

17. Aftësitë që ka menaxheri për të udhëhequr dhe komunikuar me njerëzit janë aftësitë: **1 pikë**

- A) Teknike
- B) Ndërpersonale
- C) Konceptuale
- D) Profesionale

18. Nivelet e menaxhimit mund të klasifikohen në tri kategori të gjera. Niveli i lartë, i mesëm dhe i ulët i menaxhimit. Është detyrë e menaxhimit të ulët: **1 pikë**

- A) Hartimi i planeve për nën njësitë e sipërmarrjes
- B) Përgjegjësia për sigurimin e trajnimit të punëtorëve
- C) Përgatitja e planeve strategjike dhe e politikës së sipërmarrjes
- D) Kontrolli dhe koordinimi i aktiviteteve të të gjitha departamenteve

19. Nëse shoqëria "A" ka regjistruar 400.000 lekë shpenzime dhe 500.000 lekë të ardhura, atëherë sa do të jetë fitimi i saj: **1 pikë**

- A) 100.000 lekë
- B) 400.000 lekë
- C) 500.000 lekë
- D) 900.000 lekë

20. Evoluimi i ndërmarrjeve hoteliere ndikohet nga disa faktorë. Cili nga faktorët më poshtë ndikon drejtpërdrejtë në evoluimin e ndërmarrjes. **1 pikë**

- A) Rritja e nivelit ekonomik të shoqërisë
- B) Rritja e numrit të shkollave profesionale
- C) Rritja e kërkesave të klientëve për shërbime hoteliere
- D) Lëvizja e lirë e popullatës

21. Impianti i kuzhinës në një strukturë hoteliere është i ndarë në disa sektorë, të cilët kryejnë funksione të ndryshme. Listoni katër nga sektorët kryesor të kuzhinës në hotel. **4 pikë**

- 1) \_\_\_\_\_
- 2) \_\_\_\_\_
- 3) \_\_\_\_\_
- 4) \_\_\_\_\_

22. Listoni katër problemet kryesore të hoteleve që ushtrojnë aktivitetin e tyre në zonat turistike bregdetare: **4 pikë**

- 1) \_\_\_\_\_
- 2) \_\_\_\_\_
- 3) \_\_\_\_\_
- 4) \_\_\_\_\_

23. Turizmi rural luan një rol të rëndësishëm në ekonominë kombëtare dhe rurale të një vendi. Listoni më poshtë katër nga faktorët që e bëjnë atë të tillë: **4 pikë**

- 1) \_\_\_\_\_
- 2) \_\_\_\_\_
- 3) \_\_\_\_\_
- 4) \_\_\_\_\_

24. Turizmi qytetar përfshin brenda tij lloje të shumta të lëvizjes turistike. Listoni më poshtë katër prej tyre: **4 pikë**

- 1) \_\_\_\_\_
- 2) \_\_\_\_\_
- 3) \_\_\_\_\_
- 4) \_\_\_\_\_

25. Për të ndërtuar një marrëdhënie të suksesshme midis guidës dhe turistëve, duhet të respektohen disa rregulla të përgjithshme. Listoni më poshtë katër prej tyre: **4 pikë**

- 1) \_\_\_\_\_
- 2) \_\_\_\_\_
- 3) \_\_\_\_\_
- 4) \_\_\_\_\_

26. Renditni më poshtë katër nga kriteret e përgjithshme që duhen mbajtur në konsideratë nga agjentët e udhëtimeve për hartimin e itinerarit turistik: **4 pikë**

- 1) \_\_\_\_\_
- 2) \_\_\_\_\_
- 3) \_\_\_\_\_
- 4) \_\_\_\_\_

27. Një menaxher i mirë duhet të zotërojë disa aftësi menaxhuese. Evidentoni më poshtë katër prej tyre: **4 pikë**

- 1) \_\_\_\_\_
- 2) \_\_\_\_\_
- 3) \_\_\_\_\_
- 4) \_\_\_\_\_

28. Menaxhimi i burimeve njerëzore shtrihet në katër fusha kryesore. Renditni më poshtë cilat janë ato: **4 pikë**

- 1) \_\_\_\_\_
- 2) \_\_\_\_\_
- 3) \_\_\_\_\_
- 4) \_\_\_\_\_

29. Për secilën nga llojet e pasqyrave financiare të renditura më poshtë tregoni çfarë përshkruajnë. **4 pikë**

1) Pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve

---

2) Pasqyra kesh flou (cash-flow)

---

3) Pasqyra e bilancit kontabël

---

4) Pasqyra e kapitalit të pronarit

---

30. Renditni më poshtë katër nga pasqyrat e domosdoshme që dorëzohen për llogaritjen e rezultatit financiar: **4 pikë**

1) \_\_\_\_\_

2) \_\_\_\_\_

3) \_\_\_\_\_

4) \_\_\_\_\_

